



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 si dhe nenit 30 të Rregullores (QRK) nr.04/2016 për Riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrimin, Kryetari i Komunës, merr

VENDIM

PËR ZËVËNDËSIMIN E KRYESUESIT TË KOMISIONIT KOMUNAL PËR RIINTEGRIM

Neni 1

ZËVENDËSOHET, Kryesuesi i Komisionit komunal për riintegrim, Avdullah Fazliu përshkak të skadimit të mandatit në pozicionin e Drejtorit të Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale i caktuar si Kryesues i Komisionit të cekur sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës për formimin e Komisionit komunal për riintegrim 1Nr.011-27033 i datës 23.05.2016 , dhe në vend të tij **caktohet, VLORA LIMANI HAJNUNI**, Drejtoreshë e sapozgjedhur në Drejtoratin për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale- Komuna Lipjan.

Neni 2

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Vlora Limani Hajnuni dhe Zyra Lokale për Komunitete .

1Nr. 011-27033/2
Lipjan, më 20.12.2017

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

